



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 655/5 Prot.

Tiranë, më 23 . 06 . 2025

V E N D I M

Nr. 148 , datë 23 . 06 . 2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 96 Regj., datë 18.04.2025, paraqitur nga z. E. G, në të cilën pretendon diskriminimin të fëmijës të mitur J. G, për shkak të “moshës”, nga ana e punonjësve të Policisë të Komisarariatit nr.1, Tiranë.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna nga z. G, në mes të tjerash, parashtrohet se, më datë 12.04.2024, rreth orës 18:51, është telefonuar nga një numër i panjohur dhe i është kërkuar të paraqitej në Komisariatin nr. 1, Tiranë, pasi djali i tij ndodhej aty. Pasi ka mbërritur në Komisariat, z. G është informuar se djali ishte ndaluar pranë Liqenit Artificial, pasi ishte kapur duke hedhur kapsolla.

Ankuesi shprehet se, pas kërkesës së tij për të takuar fëmijën, është njoftuar oficeri i Policisë Gjyqësore, z. A. D, i cili e ka shoqëruar në dhomën ku ndodhej djali i tij. Z. G pretendon se djali ndodhej i vetëm, pa praninë e një psikologu apo punonjësi tjetër përgjegjës, në një gjendje të rënduar emocionale dhe duke qarë.

Z. G shprehet se: “Në fytyrën e tij, konkretisht në anën e djathtë poshtë syrit, kishte një shenjë të dukshme skuqeje, që shtrihej deri në drejtim të veshit.

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD.

J. tregoi se ishin thirrur për të ndaluar së bashku me katër shokë të tij, e ndërsa shokët e tij ishin larguar me vrap kur punonjësit e Policisë kishin ndërhyrë, J. kishte qëndruar në vend dhe ishte kapur nga tre efektivë policie të veshur me uniformë dhe dy civilë, të cilët, sipas rrëfimit të tij, e kishin shtrirë përdhe, i kishin vendosur pranga dhe më pas, e kishin shoqëruar për në Komisariat.

Sipas fjalëve të J, gjatë shoqërimit, është goditur me shpulla dhe grushte nga tre efektivë policie, përfshirë edhe një punonjëse policie grua, e cila ka përdorur shprehje fyese dhe ofendime të rënda karshi tij.

Në mjetin e policisë, gjatë transportit i është ofruar cigare dhe është kërcënuar që të mos tregonte të vërtetën për atë që kishte ndodhur”.

Ankuesi shprehet se, kur ishte në Komisariat ka kërkuar ndihmë mjekësore për fëmijën dhe se urgjenca ka mbërritur pas rreth 10 minutash. Më pas, J. është dërguar në Spitalin Ushtarak, ku ka marrë trajtim mjekësor dhe ka dhënë dëshminë e tij në prani të psikologes, OPGJ-së, Shefit të Krimeve, prindërve të tij dhe avokatit të familjes.

Prindi i fëmijës, z. E. G pretendon se ky akt i rëndë karshi fëmijës së tij përbën jo vetëm shkelje të rëndë të të drejtave kushtetuese dhe lirive themelore që garantojnë mbrojtje të të drejtave të fëmijës.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Dinjteti i njeriut dhe të drejtat dhe liritë e tij, sanksionohen në nenin 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Detyrimi i shtetit është, jo vetëm të mos i cenojë vetë ato, por ai duhet të marrë masa dhe të ofrojë garancitë e duhura për të siguruar mos cënimin, për t'i mbrojtur dhe për të garantuar gëzimin e tyre nga të gjithë individët.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, sanksionon në nenin 18 se : " *Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatesia prindërore. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive. "*

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Europiane e të Drejtave

të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta. Neni 14 i Konventës garanton barazinë “në gëzimin e të drejtave dhe lirive” të përcaktuara në të. Protokollin 12 i saj ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe në fushëveprimin e tij sesa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Me qëllim marrjen e informacionit më të plotë lidhur me ngjarjen e paraqitur;

- Njëpëmjet shkresës me nr. 655/2 prot., datë 28.04.2025, Komisioneri i është drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore (AMP), lidhur me kërkesën nëse për ngjarjen në fjalë është depozituar kallëzim kundër punonjësve të Policisë të Komisarariatit nr. 1, Tiranë, si dhe nëse rasti është në shqyrtim/hetim nga ana tyre.

- Me shkresën me nr. K-21/2 prot., datë 06.05.2025, AMP, informon Komisionerin se:

“Me datë 13.04.2025, AMP, Drejtoria Rajonale Tiranë, menjëherë pasi ka marrë njoftimin për këtë ngjarje, ka kryer veprimet hetimore paraprake, duke administruar edhe kallëzimet respektive të shtetasve të dëmtuar (E dhe J. G).

Materiali kallëzues me shkresën me nr. 76 prot., datë 15.04.2025, është referuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në ngarkim të tre punonjësve të policisë të Komisarariatit të Policisë nr. 1, Tiranë: Nënkomisar XH. B, Inspektor R. D dhe Inspektor D. M, për veprat penale “Kryerje e veprimeve arbitrare” dhe “Dëmtime të tjera me dashje”, të parashikuara përkatësisht nga nenet 250 dhe 90, të Kodit Penal.

Gjithashtu, AMP, ka rekomanduar menjëherë fillimin e ecures disiplinore për shkelje të rënda për tre punonjësit e policisë, të përfshirë në veprime në shkelje të ligjit, në dëm të shtetasit të mitur J. G.

Në vijim, nga ana e Prokurorisë, bazuar mbi këtë material kallëzues është regjistruar procedimi penal respektiv dhe aktualisht për këtë procedim po zhvillohen hetime nën drejtimin e prokurorit të çështjes.”

- Me shkresën me nr. 11903/1 prot. A. N, datë 12.05.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ka njohur Komisionerin me faktin se:

“....lidhur me informacionin e kërkuar për ankesën e shtetasit E. G për dhunën e ushtruar ndaj djalit të mitur J. G, ju bëjmë me dije se, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ka regjistruar procedimin penal me nr. 2847, datë 25.04.2025, për veprën penale “Kryerja e veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 250, i Kodit Penal, me autor të regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale shtetasit: Xh. B, R. D dhe D. M.

Pas komunikimit me prokuroren e çështjes na u bë me dije se i është drejtuar me kërkesë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pezullimin nga detyra të punonjësve të policisë, kërkesë e cila është pranuar nga Gjykata. Çështja vijon të jetë në fazën e hetimeve.”

Referuar të dhënave e fakteve sa më sipër, Komisioneri vëren se;

Pretendimi i ankuesit lidhur me veprimet dhe dhunën e ushtruar nga tre punonjësit e policisë të Komisarariatit të Policisë nr. 1, Tiranë, kundrejt fëmijës së mitur J. G, qartazi i lidh veprimet e këtyre të fundit, (punonjës policie në ushtrim të detyrës, të përfshirë në veprime në shkelje të ligjit, në dëm të shtetasit të mitur J. Gj), me akuzën për konsumim të elementëve të veprës penale të shpërdorimit të detyrës.

Aktualisht, si persona të akuzuar dhe nën hetim për veprën penale “Kryerja e veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 250, i Kodit Penal, i cili përcakton se:

“Kryerja e veprimeve ose dhënia e urdhrave arbitrare, nga ana e punonjësit që kryen një funksion shtetëror ose një shërbim publik gjatë ushtrimit të detyrës së tij, të cilat prekin lirinë e shtetasve, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në shtatë vjet.”

Neni 1, dhe 1/b, i Kodit Penal, përcakton se: *“Ligji penal përcakton veprat penale, dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj autorëve të tyre. Veprat penale ndahen në krime dhe në*

kundravajtje penale. Legjislacioni penal i Republikës së Shqipërisë ka për detyrë të mbrojë pavarësinë e shtetit dhe tërësinë e territorit të tij, dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, rendin kushtetues, pronën, mjedisin, bashkëjetesën dhe mirëkuptimin e shqiptarëve me pakicat kombëtare, si dhe bashkëjetesën fetare nga veprat penale, si dhe parandalimin e tyre”.

Kodi i Procedurës Penale, në nenet 277 e 278 të tij, ka parashikuar organet kompetente që ushtrojnë ndjekjen penale dhe që shprehen e disponojnë lidhur me të, shprehimisht: *“Prokurori dhe policia gjyqësore zhvillojnë, brenda kompetencave të caktuara, hetimet e nevojshme që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale. Prokurori drejton hetimet dhe ka në dispozicion policinë gjyqësore. Gjatë hetimeve paraprake, për rastet e parashikuara nga ligji, mbi kërkesën e prokurorit, të pandehurit, viktimës dhe palëve private, vendos gjykata.”*

Nisur nga sa më sipër, lidhur me ngjarjen në fjalë, është organi i Prokurorisë, organi kompetent që ushtron ndjekjen penale.²

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ka regjistruar procedimin penal me nr. 2847, datë 25.04.2025, për veprën penale “Kryerja e veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 250, i Kodit Penal, me autor të regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale shtetasit: Xh. B, R. D dhe D. M.

Prokurori i çështjes i është drejtuar me kërkesë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pezullimin nga detyra të tre punonjësve të policisë, kërkesë e cila është pranuar nga Gjykata dhe çështja vijon të jetë në fazën e hetimeve.

Për rrjedhojë, nisur nga sa më sipër, Komisioneri vëren se, hetimi i veprimeve, për të cilat ka dyshime të arsyeshme se mund të përbëjnë elementë të veprës penale, *(dhe janë në hetim e shqyrtim nga organet përkatëse kompetente, si Prokurori e Gjykatë)*, nuk bën pjesë në kompetencën e KMD-së³.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, i cili citon se *“Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ...”*, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 33, pika 4, shkronja ç), nenin 33, pika 10, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

² Neni 148, i Kushtetutës së Shqipërisë shpreh se: *“Prokuroria ushtron ndjekjen penale...”*

³ Për analogji citojmë vendimet: nr. 22, datë 19.01.2024, nr. 218, datë 05.08.2024, nr. 85, datë 14.04.2025, etj, të KMD-së.

1. Mospranimin e ankesës së z. E. G, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA